

VENDIM
Nr. 277, datë 13.4.2016

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS, TË PRONËS NR. 1147, ME EMËRTIM “BANKINË”, ME VENDNDODHJE NË BUNEC, LUKOVË, SARANDË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, të pronës nr. 1147, me emërtim “Bankinë”, me vendndodhje në Bunec, Lukovë, Sarandë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për trajtimin e kërkesave të operatorëve, në kuadrin e partneritetit publik privat, për përmirësimin e infrastrukturës së pontilit sipas standardeve të sigurisë lundrimore, për shfrytëzimin e potencialit të lartë ekonomik dhe për krijimin e kapaciteteve të eksportit të ujit të pijshëm.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, hiqet prona nr. 1147, me emërtim “Bankinë”, me vendndodhje në Bunec, Lukovë, Sarandë.

3. Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.


4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**Planvendosja e Pronës Nr.1147(BANKINA)
Bunec, Lukove, Sarande**

SISTEMI KORDINATAVE LOKALE

431 150			
431 050		Shpjeguse: Sip.e përgjithshme = 2.135 m² Sip.e Bankinës = 811 m² Sip. e Sheshit +Rrugë = 1.324 m² MIRATOHET Komandanti i Forcës Detare Gjeneral Brigadë Vllber DOGJANI  Shënim:Kjo planvendosje u hartua në zbatim të shkresës së SHSHP të FA-së, nr.1195/2, datë 16.02.2016 dhe mbi planvendosjen e marrë në arkivin e IGJIU-së hartuar në Dhjetor 2011	Shkurt 2016
4 430 850 4 405 080		405 330	530

Hartoi
Topograf Ramiz Haxhiu

Shkalla 1:2500

DREJTORI I IGJIU
N/Kolonel Zydi **ALCAN**